

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

28.04.2022
Ora 12:12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të subjekteve zgjedhore Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, ndaj Bashkisë Durrës, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. M. Koja**
- **Parti Politike:** **PD, z. Marash Logu**
- **Bashkia Durrës:** **S’ka prezent**
- **OJQ:** **KRIK**


Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, atëherë fillojmë seancën publike për shqyrtimin e këtyre çështje:

Kemi shpalljen e vendimit për shqyrtimin e denoncimit të subjekteve zgjedhore, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, ndaj Bashkisë Durrës për shkelje administrative të pretenduara si të ndodhura në fushatën zgjedhore të 6 marsit.

Pika e dytë, edhe kjo lidhet me shpalljen e vendimit për shqyrtimin e denoncimit të subjektit zgjedhor Partia Demokratike ndaj Bashkisë Rrogozhinë për shkelje të administrative të ndodhura në fushatën zgjedhore të 6 Marsit 2022.

Pika e tretë, po ashtu lidhet me shpalljen e vendimit për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj drejtorit të shkollës 9-vjeçare

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

“Armath” Durrës dhe kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Durrës, propozuar nga Partia Socialiste po për zgjedhjet e 6 Marsit 2022.

Pika e katërt, ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit, po të organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Durrës si dhe Autoritetit Portual Durrës, Drejtorit të Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, për fushatën e 6 Marsit 2022.

Pika e pestë, shqyrtimi i denoncimit po të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Lushnje, propozuar nga Partia Socialiste, Ministres së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të spitalit Lushnje, po për fushatën e datës 6 Mars 2022.

Pika e gjashtë, shqyrtimi i denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kryetarit dhe sekretarit të Këshillit Bashkiak, Shkodër për shkelje administrative në fushatën zgjedhore të datës 6 Mars 2022.

Atëherë fillojmë me shpalljen e vendimit për të tre çështjet për të cilat ne përfunduam...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për procedurë, i nderuar!

Z. I. Celibashi: Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në fakt është pak e habitshme që pika e dytë e rendit të ditës thotë: Për shpalljen e vendimit në lidhje me shqyrtimin e denoncimit të subjektit tonë ndaj Bashkisë Rrogozhinë. Ne jemi në fazën që nuk është mbyllur ende hetimi administrative. Ne në seancën e kaluar, kërkuam që të merrnim kohë, në mënyrë që të merrnim provat e reja që kishte sjellë Bashkia Rrogozhinë. Tani vetëm po ka ndodhur ndonjë seancë pa dijeninë tonë dhe këtu rezervohemi. Në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

dijeninë tonë, ne jemi në fazën që jemi njohur me provat, duhet të shprehemi për to, në qoftë se kemi kërkesa të tjera proceduriale, Komisioneri do t'i vlerësojë. Në rast të kundërt do të mbyllet hetimi administrativ dhe ne do të paraqesim pretendimet tona ose konkluzionet përfundimtare. Besoj se kjo pikë duhet të rishikohet.

Z. I. Celibashi: Vetëm një sekondë, të verifikojmë në lidhje me sa thatë tani. Seanca 13.04.2022 ka qenë e fundit në mos gaboj?!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po!

Z. I. Celibashi: Nga kjo çfarë unë kam të shënuar, më rezulton që keni kërkuar kohë për t'u njohur dhe do të sillnit prapësimet për këtë..


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, kemi kërkuar kohë që të njihemi me këto prova. Nuk i është dhënë fund hetimit administrativ, në dijeninë time, apo jo? Nuk jemi në momentin e shpalljes së vendimit, apo jo?

Z. I. Celibashi: Kemi konsideruar që meqenëse deri ditën e sotme nuk është paraqitur asnjë pretendim, asnjë prapësim. Por gjithësesi e konsiderojmë që mund t'i paraqisni ato pretendime dhe të mos e shpallim vendimin për rastin e Rrogozhinës.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Këtu më rezulton se... Po keni kërkuar kohë për këtë dhe është lënë që të sillni përsëri prapësimet, por meqenëse është menduar...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Zoti Logu, pa mikrofon, nuk dëgjohet!


Z. I. Celibashi: Dakord! Mirë për rastin e parë, pra për denoncimin që Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste kanë bërë ndaj Bashkisë Durrës, e kemi përfunduar shqyrtimin administrativ, po kështu dhe për denoncimin e bërë nga Qëndresa Qytetare për rastin e Shkollës 9-vjeçare “Armath”. Shpallim vendimin për këto dy kërkesa dhe pastaj vazhdojmë me procedurën që ka të bëjë me rastin e denoncimit për Rrogozhinën.

Për sa i përket denoncimit të parë nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kundrejt kandidates për kryetare të Bashkisë Durrës, propozuar nga Partia Socialiste, do të japim vendimin. E kemi dhe të arsyetuar, po shpall thjesht pjesën urdhëruese, dispozitivin e këtij vendimi. Në vlerësim të të gjithë atyre çfarë u pretendua nga palët, vendos që:

1. Ta përfundoj shqyrtimin administrativ të denoncimit ndaj Bashkisë Durrës.
2. Moskonstatimin e shkeljeve së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë, 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
3. Rezultatet e këtij vendimi do t’u bëhen publike palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 151

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.04.2022*

28.04.2022
Ora 12:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Armath”, kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Durrës, zonja Emiriana Sako, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Staf i KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja**

• **Parti Politike:** **PD, z. Marash Logu**

• **OJQ** **KRIK**

• **Të tjerë:**


1. Organizata “Qëndresa Qytetare”, zoti **Rigels Xhemollari**.

2. Drejtor i Shkollës 9-vjeçare

“Armath”, Durrës **zoti Vlash Doda**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, në lidhje me veprimtarinë e drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Armath” dhe kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, të propozuar nga Partia Socialiste. Në vlerësim të pretendimeve të palëve pjesëmarrëse në procesin administrativ, vlerësojmë se pretendimet e denoncuesit janë të bazuara në Kodin Zgjedhor si dhe në vendimin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.04.2022*

nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj vendosim:

1. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Armath”, zotit Vlash Doda në shumën e pesë mijë lekëve.
2. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj kandidatit për kryetar Bashkie Durrës të propozuar nga Partia Socialiste në shumën e njëqind mijë lekëve.
3. Rezultatet e këtij vendimi do t’u bëhen publike palëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 152

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

28.04.2022
Ora 12:23

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, për shkelje të parashikuar në nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Bashkisë Rrogozhinë”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja**
- **Parti Politike:** **PD, z. Marash Logu**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të Partisë Demokratike në lidhje me kandidatin për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, propozuar nga Partia Socialiste. Vazhdojmë me pretendimet tuaja përfundimtare në lidhje me këtë çështje, faleminderit!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner, me gjithë keqardhjen për vendimmarrjen tuaj në vlerësimin tonë, aspak të drejtë për rastin e Bashkisë Durrës. Aty u provua përtej çdo dyshimi të arësyeshem, përfshirë dhe fushatën zgjedhore ku Bashkia Durrës shpërndau 3.5 milion euro për ndihma, për fondet e tërmetit, bursa studimi dhe ndihmë ekonomike. Megjithatë besoj se ai rast do të diskutohet edhe në instanca të tjera. Duke u ndalur tek rasti i Bashkisë Rrogozhinë, së pari është pak i çuditshëm, ose i habitshëm do të thoja, guximi që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

kanë institucionet për t'u tallur. Për t'u tallur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për t'u tallur me përfaqësuesit e partive politike, duke sjellë shkresa që kanë kundërthënie të shumta me njëra-tjetrën, gati absurde. Megjithatë do të kem mundësi që të ndalem se megjithë dokumentacionin që përpiqen të jetë në dukje voluminoz, shoh se ka disa gjëra që ne nuk na interesojnë. Psh ne nuk na intereson historiku i punësimeve të përkohshme në Bashkinë Rrogozhinë. Kjo nuk provon gjë tjetër përveç faktit se kryetari i Bashkisë Rrogozhinë punëson njerëz në mënyrë të përkohshme pa procedurë. Pa verifikime, pa kritere etj., etj. Kjo nuk është çështje që unë mendoj se do të diskutohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në shkresën e datës 25 mars 2022, kryetari i Bashkisë Rrogozhinë pranon që janë emëruar 27 punonjës në datat 20 dhe 21 janar 2022. Aktet e emërimit, thotë që “nuk janë shoqëruar me kontrata pune”. Pra, megjithëse janë punësuar 27 punonjës për Bashkinë Rrogozhinë nuk është e nevojshme që të kenë kontrata pune. Në lidhje me procedurën e rekrutimit thotë “nuk është ndjekur ndonjë procedurë specifike, nuk ka pas kritere të posaçme dhe disa prej tyre kanë qenë të punësuar pranë Bashkisë Rrogozhinë. Disa të tjerë janë qytetarë që paraqiten në bashki dhe kërkojnë punë”. Tani ju e dini zoti Komisioner, që unë e pyeta përfaqësuesen e Bashkisë Rrogozhinë, nuk e di nëse Bashkia Rrogozhinë ka ndonjë përfaqësues sot? E pyeta se pse është përzgjedhur “x” dhe jo “y”, se pranë Bashkisë Rrogozhinë besoj se mund të ketë një numër shumë të madh njerëzish që shkojnë dhe ankohen për probleme të ndryshme, përfshirë papunësinë. E pyeta se si janë rekrutuar këta persona? Institucionet ndjekin rregulla të caktuara për punësimin e njerëzve. Jo çdo njeri që paraqitet pranë një institucioni për të kërkuar punë detyrimisht merret në punë. Ka procedurë, kritere, etj., etj., në mënyrë që të mos diskriminohen njerëzit të cilët mund të jenë më të aftë dhe më të zotët për t'u punësuar pranë kësaj bashkie. Tani provat që na janë paraqitur, unë vlerësoj se nuk duhen pranuar, sepse nuk kanë lidhje me shqyrtimin

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*


që ne po bëjmë. Na janë paraqitur aktet e punësimit të disa punonjësve që janë punësuar më parë dhe nuk kanë lidhje me 27 punonjësit që ne kemi denoncuar dhe disa kontrata pune të punonjësve sezonalë të emëruar para dekretimit të datës së zgjedhjeve që në këtë rast nuk besoj se janë me interes. Ajo që mund të jetë me interes në fakt dhe që provon se një institucion shtetëror shkel ligjin në mënyrë flagrante dhe që thajse bën tallje me institucionet, është një kontratë pune e cila kam përshtypjen që u ka shpëtuar se nuk besoj se do të donin ta sillnin. Ata megjithëse pranojnë që aktet e emërimit nuk janë shoqëruar me kontrata pune, për zotin Besnik Memolla ka një kontratë pune. Është shumë interesant rasti i zotit Besnik Memolla sepse në provat që janë paraqitur nga vetë Bashkia Rrogozhinë, ka një kundërthënie shumë të madhe që është si vijon. Rezulton që zoti Memolla është punësuar... ka pasur një urdhër për punësimin e tij në datën 21 janar. Ndërkohë që kontrata e punës është lidhur në datën 19 janar. Besoj që për ne që kuptojmë.. s'ka nevojë të kuptojmë ose të kesh njohuri të thelluara në këtë fushë, por mjafton të njohësh abc-në e administratës, fillimisht një person emërohet në detyrë dhe pastaj nënshkruhet kontrata e punës. Kjo në vlerësimin tonë zoti Komisioner, provon qartazi që pasi ka marrë denoncimin që ka bërë Partia Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Bashkia Rrogozhinë ka bërë përpjekje që të rregullojë dokumentacionin. Të nxjerrë urdhëra, të përpiqet të justifikojë, të arsyetojë etj., etj. Psh paraqitet si shkak i emërimit një e-mail që ka ardhur nga Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Ku u thotë “merrni masa...” nuk i thotë Bashkisë Rrogozhinë, në fakt u thotë të gjitha bashkive. E ka kryesisht për bashkitë që janë në zona malore se flitet për temperatura të ulëta, akuj, borë etj., etj. Unë nuk besoj se ky ishte rasti i Bashkisë Rrogozhinë. Pavarësisht se e-mail-i ka ardhur në datën 21, Bashkia Rrogozhinë na thotë ne që “punësimet i ka bërë që në datën 20”. Pra, e-mail-i që ka shërbyer si arsye ka ardhur pasi janë kryer këto punësime. Për ne është shumë e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

qartë që Bashkia Rrogozhinë të 27 punësimet e përkohshme që i ka kryer në datat 20 dhe 21 janar, siç e kemi thënë prej fillimit të kësaj çështjeje, ne atëherë kishim vetëm indicie. Faktet dhe dokumentet që ka sjellë Bashkia Rrogozhinë, kanë konfirmuar denoncimin tonë, janë bërë vetëm e vetëm me qëllime elektorale. Një bashki kaq modeste dhe e vogël në numër popullsie, por normalisht besoj dhe në administratë, punëson një ditë pas dekretimit të zgjedhjeve 27 persona, pa kontratë pune, pa procedurë rekrutimi, pa kritere të posaçme. Unë besoj, se ju vetë zoti Komisioner keni qenë drejtues institucionesh, në qoftë se ju ka ndodhur ndonjëherë që të punësoni dikë pa procedurë, pa kritere dhe plotësisht në diskrecionin tuaj, unë besoj se kjo nuk ndodh në asnjë institucion, përveç se kur ka arsye të tjera. Madje as në persona juridikë privatë nuk ndodh që personat të punësohen kështu pa kritere, pa procedura, pa bërë asgjë, thjesht sipas dëshirës së kryetarit të bashkisë. Ne vlerësojmë, për të mos përsëritur dhe ato që kemi pas mundësi t'i themi në seanca të tjera, që e gjithë kjo procedurë dhe të gjitha këto punësime janë kryer me qëllimin e qartë dhe të pastër në mënyrë që këta 27 persona që janë nga 27 familje etj., etj., të ishin të angazhuar në fushatën elektorale të kandidatit të Partisë Socialiste që qëllonte të ishte dhe kryetari i bashkisë. Në një bashki siç është kjo e Rrogozhinës besoj se të gjithë e kuptojmë se një numër i tillë punonjësish ka një impakt të caktuar, sepse edhe në Bashkinë Tiranë, pra dhe në bashki që do të ishin më të mëdha do të kishte një lloj impakti, por në bashki të tilla ka një impakt më të madh. Aq më tepër po e përsëris dhe një herë që bëhet fjalë për punonjës të marrë krejtësisht në diskrecionin e kryetarit të bashkisë, pa pasur asnjë lloj kriteri dhe asnjë lloj procedure. Siç provohet dhe nga dokumentacioni i sjellë nuk ka asnjë lidhje me e-mail-in e datës 21. Në fakt punësimet kanë filluar një pjesë në datën 20 dhe një pjesë në datën 21. Nuk besoj se Bashkia Rrogozhinë ka aftësinë telepatike ta parashikojë që në datën 21 do t'i vijë një e-mail dhe të fillojmë të punësojmë njerëz që në datën

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

20, në mënyrë që kur të vijë e-mail-i të na gjejë të përgatitur. Do ta mbyll me këtë gjë zoti Komisioner që në fakt për ne ka qenë një nga arësyet që në zgjedhjet e 25 Prillit 2021, Partia Demokratike nuk ka paraqitur një numër aq të madh ankesash, megjithëse kemi konstatuar një numër shumë të madh shkeljesh, për shkak se kandidatëve kjo, po u kthehet një mjet joefektiv. Megjithëse të gjithë biem dakord, evidentohet dhe në raporte ndërkombëtare, ose të OSBE/ODIHR-it, Departamentit Amerikan të Shtetit, apo raporte të tjera të organizatave joqeveritare, një prej të cilave është këtu, që përdoren masivisht fondet dhe burimet shtetërore për fushata elektorale, askush nuk ndëshkohet. Shpresojmë shumë që ajo masa që morët ju për shkollën dhe Bashkinë Durrës të mos rrëzohet nga Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve se dhe ka ndodhur. Edhe ata kanë ato interpretimet e tyre të posaçme se çfarë konsiderohet shkelje, apo nuk konsiderohet. Në këtë rast ne duam të shpresojmë dhe kjo ka qenë arsyeja pse unë e kam investuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që duket qartazi arsyeja pse janë bërë këto 27 punësime në Bashkinë e Rrogozhinës. A kisha unë dyshimin se Bashkia Rrogozhinë nuk do arrijë të gjejë një justifikim? Ose bashkia Durrës? Sigurisht ata gjithmonë do të përpiqen të gjejnë diçka majtas, djathtas. Një lloj arsëyetime për të thënë që “këto punësime nuk i kemi bërë për fushatë elektorale”. Nuk besoj që presim të na vijë këtu ndonjë bashki e të na thotë që “ne punësojmë njerëz për fushatë”. Shkelja në këtë rast duket qartë dhe dokumentet që na ka sjellë Bashkia Rrogozhinë janë të qarta. Për ta përmbyllur zoti Komisioner, unë mendoj se provat e sjella nga Bashkia Rrogozhinë në datën 25.03.2022 dhe të administruara pranë KQZ-së në datën 30 mars nuk duhet të administrohen sepse nuk i përkasin objektit të hetimit të kësaj çështjeje. Pra, janë kontrata dhe urdhëra për emërimin e disa personave që nuk kanë qenë aspak objekt i hetimit të kësaj çështjeje. Nisur dhe nga ajo që ne kemi kërkuar në seancën e datës 13 prill, faleminderit!


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit ju! Atëherë, e përfundojmë hetimin administrativ të kësaj çështje dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë një ditë tjetër, për të cilën do të njoftohen palët zyrtarisht.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

28.04.2022
Ora 12:34

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Emiriana Sako, Autoritetit Portual Durrës, z. Klevis Hysa Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja**
- **Parti Politike:** **PD, z. Marash Logu**
- **OJQ:** **KRIK**
- **Të tjerë:**
 - **Organizata “Qëndresa Qytetare”, zoti Rigels Xhemollari.**
 - **Autoriteti Portual Durrës, zoti Aleks Marku.**
 - **Universiteti “Aleksandër Moisiu”, znj. Anjeza Bejko.**
 - **Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, znj. Blerina Qyrana.**

Z. I. Celibashi: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, pra me pikën e katërt, që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj kryetares së Bashkisë Durrës, në atë kohë dhe sot pas zgjedhjeve, Autoritetit Portual Durrës, drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës për shkelje

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për kryetar bashkie të datës 6 mars. Atëherë, prezent janë përfaqësuesit e Organizatës “Qëndresa Qytetare”, nga Bashkia Durrës? S’ka prezent!

Nga Autoriteti Portual?

Z. A. Marku, Autoriteti Portual Durrës: Po, prezent!

Z. I. Celibashi: Nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”?

Znj. A. Bejko, Universiteti “Aleksandër Moisiu”: Po prezent!


Z. I. Celibashi: Edhe nga Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive?

Znj. B. Qyrana, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive: Po prezent!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Në seancën e shkuar kemi vendosur që bazuar në pyetjet që bëri përfaqësuesi i Qëndresës, Autoriteti Portual do të duhej të vinte sot me shpjegimet dhe përgjigjet, kështu e kemi lënë, mos gabojmë?! Vazhdojmë!

Z. A. Marku, Autoriteti Portual Durrës: I nderuar Komisioner, në përfundim të seancës së kaluar, u ngarkua Autoriteti Portual Durrës të sillte provë shtesë që u kërkua nga pala denoncuese Qëndresa Qytetare, e cila i është përcjellë me shkresën nr.1410/1, datë 26.04.2022. Ky dokumentacion i është përcjellë elektronikisht edhe Qëndresës Qytetare që të vihej në vijim të dokumentacionit para seancës së sotme.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Nga përfaqësuesi i Organizatës “Qëndresa Qytetare”? Ju keni marrë dijeni për atë, ju ka ardhur dokumentacioni, por më duket se dhe Komisioni Qendror ua ka nisur zyrtarisht?

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Mund të bëj një koment?

Z. I. Celibashi: Po, fjala është për ju! Më parë më thoni nëse është përmbushur kërkesa juaj apo jo?!

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Po kemi marrë dijeni!

Z. I. Celibashi: Dakord, doni të bëni një koment për këtë, apo doni të vazhdoni me diskutimin përfundimtar në lidhje me këtë çështje?

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Do të bëj diskutimin përfundimtar!


Z. I. Celibashi: Dakord, nga përfaqësuesit e Agjensisë Kombëtare?

Znj. B. Qyrana, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive: Në fakt në lidhje me këtë të fundit nuk është se kemi marrë dijeni, megjithatë do t’ia kërkojmë palës, autoritetit që të na e verë në dispozicion.

Z. I. Celibashi: Dakord! Nga rektorati i universitetit, kemi ndonjë ndërhyrje?

Znj. A. Bejko, Universiteti “Aleksandër Moisiu”: Jo!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë fjala për ju, për diskutimin përfundimtar në lidhje me këtë çështje dhe pastaj për përfaqësuesit e palëve të tjera!

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: I nderuar Komisioner, nisur dhe nga parashtrimet e palëve dhe nga prapësimet tona gjatë këtij procesi, më duhet të bëj një përmbledhje finale të asaj se çfarë është konstatuar. Në datën 12 mars sipas çfarë palët parashtrojnë, është organizuar aktiviteti i pretenduar në mjedisin e Portit Durrës, në sallën e konferencave, me prezencën e kandidatës së Partisë Socialiste, zonjës Emirjana Sako dhe drejtuesve të AKPA, UAM dhe Autoritetit Portual Durrës. Bazuar në shkresat e institucioneve, aktiviteti i realizuar nga CEMA që është Qendra e Ekselencës, pjesë integrale e Portit Durrës, pra jo një person juridik i ndarë nga Autoriteti Portual. Së treti, në referim të shkresave të Bashkisë Durrës dhe UAMD, vihet re përmbajtja e ftesës ku thuhet se ju ftojme në aktivitetin e thirrjes publike “shpallje e programit të specializimeve në fushën e administrimit portual”. Pra, kemi të bëjmë me një takim publik, me pjesëmarrje të konsiderueshme. Së katërti, në këtë aktivitet kandidatit për kryetare bashkie Emirjana Sako, ka bërë premtime. Në rrjetin e saj social thuhet “në takimin e zhvilluar në mjediset e portit me drejtues të Autoritetit Portual dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, bëmë të ditur se në fazën e parë do të jenë dhjetë të rinj që do të përfitojnë eksperiencë pune për t’u integruar me profesionistë karriere në administratën portuale. Ne ju bëmë të ditur studentëve të Bashkisë së Durrësit që do të shpërndajmë dy mijë kartat e para të studentit të cilët do të përfitojnë një sërë lehtësirash në jetën e përditëshme”. Këtë e provon edhe prova shtesë që erdhi nga përfaqësuesit e Autoritetit Portual, ku në planin vjetor thuhet se një nga qëllimet e aktivitetit të Qendrës së Ekselencës është “punësimi i të rinjëve në fushën e detarisë” që lidhet edhe me premtimin që ka bërë kandidatit. Së pesti, ftesa i është drejtuar zonjës Sako në e-mail-in e saj personal dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

jo Bashkisë së Durrësit si institucion. Fakt që implikon dhe favorizimin e kandidatës në periudhë zgjedhore. Bazuar në vendimin nr. 2, dt. 22.01.2022 të Komisionit Rregullator, për drejtuesit e organeve publike që marrin pjesë në aktivitete me karakter publik, duhet të njoftojnë në ndërfaqen e KQZ-së. Fakt ky që në faqen tuaj, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk është publikuar ky aktivitet. Pra, kemi të bëjmë me burime, siç është porti, drejtues institucionesh të vënë në dispozicion të kandidatëve, por kemi të bëjmë dhe me një aktivitet që nuk është raportuar. Në qoftë se do të ishte raportuar, ndoshta dhe nga ana juaj mund të ishte shpallur aktiviteti i palejuar për t'u organizuar. Në kuadër të këtij konstatimi, ne kërkojmë: konstatimin e shkeljes nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve për përfaqësuesit e institucioneve, drejtorin e Autoritetit Portual Durrës, Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit, kandidaten për kryetare të Bashkisë Durrës dhe rektoren e Universitetit "Aleksandër Moisiu", faleminderit!


Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Fjala për diskutimin përfundimtar për secilin prej jush, palë në këtë proces administrativ. Nga Bashkia Durrës nuk kemi prezent?!

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. I. Celibashi: Atëherë nga Autoriteti Portual Durrës, po!

Z. A. Marku, Autoriteti Portual Durrës: Atëherë, i nderuar zoti Komisioner, Autoriteti Portual Durrës në qëndrimin e tij, u qëndron shpjegimeve me shkrim të sjella pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nga ana e palës denoncuese i referohet titullit të aktivitetit "thirrje publike", por që kjo nuk e bën aktivitetin në vetvehte publik. Ashtu siç e kemi shpjeguar, aktiviteti ka qenë takim i partnerëve të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

CEMA-s me instuticione që ushtrojnë veprimtarinë në fushën detare, ku ka qenë dhe universiteti i Durrësit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit. Pra, është një takim i ngushtë dhe në kufizimet e vendimit të Komisionit Rregullator është qartë e përcaktuar se kush janë veprimtari publike. Pra, janë ato veprimtari të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe të medias. Ndërkohë ky takim është takim mes partnerëve të CEMA-s, nuk është i hapur për publikun e gjerë dhe nuk është as mediatik dhe për rrjedhojë nuk është klasifikuar tek ajo kategori aktiviteteesh që do të duhet të raportohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e konsiderojmë si të tillë. Në përfundim të pretendimeve tona, vlerësojmë se nuk jemi në rrethana të shkeljes dhe duhet të pushohet procedimi administrativ ndaj Autoritetit Portual Durrës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, nga përfaqësuesi i universitetit, diskutimi përfundimtar?!

Znj. A. Bejko, Universiteti “Aleksandër Moisiu”: Po i nderuar! I qëndrojmë gjithë prapësimeve që ka paraqitur universiteti zyrtarisht pranë komisionerit. Gjithashtu theksojmë për ta përmbledhur që ky është një aktivitet që është organizuar në kuadër të partneritetit që ka universiteti i Durrësit me Autoritetin Portual Durrës dhe Qendrën e Ekselencës, për çështje detare dhe është në përputhje me misionin e universitetit me qëllim promovimin dhe specializimin e studentëve. Pra, i shërben qëllimit të universitetit, si instuticion i arësimit të lartë. Pjesëmarrja e rektores në aktivitet ka qenë një pjesëmarrje protokollare, sepse ajo është përfaqësuese e universitetit për çështjet akademike dhe protokollare. Ky është një aktivitet i organizuar me ftesë të Autoritetit Portual Durrës dhe nuk është organizuar nga universiteti dhe nuk ka pse universiteti të ketë përgjegjësi për raportim të këtij

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

aktiviteti në ndërfaqen e KQZ-së. Ajo që shihet është një aktivitet i zhvilluar midis disa institucioneve, pra nuk është një aktivitet publik në vështrimin tonë. Për sa i përket pretendimit që paraqiti Qëndresa Qytetare që më pas kandidatja për kryetare ka bërë një premtim për kartat e studentëve. Ky është një premtim elektoral i bërë nga kryetaria, nuk ka universiteti ndonjë përgjegjësi ndaj një premtimi që bën një kandidat. Aq më tepër që paisja e studentëve me karta është një detyrim ligjor dhe nuk ka pse të bëhet një premtim në lidhje me këtë çështje. Për pasojë kërkojmë: mosmarrjen në konsideratë të denoncimit në lidhje me rektoren e universitetit në lidhje me këtë çështje.

Z. I. Celibashi: Ju faleminderit! Po përfaqësuesi i Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive?!

Znj. B. Qyrana, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive: I nderuar Komisioner, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive i qëndron të gjitha shpjegimeve që ka parashtruar në shkresën 726/1, datë 3.03.2022. Dua t'u theksoj dy, tre çështje që agjensia në aktivitetin e sipërcituar nuk ka qenë organizatore, si rrjedhojë nuk ka pas detyrimin për të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së. Për më tepër kjo veprimtari nuk ka qenë një veprimtari me karakter as publik e as politik dhe nuk ka qenë takim i hapur për median dhe për publikun. Ashtu siç tha dhe përfaqësuesi i universitetit dhe i Autoritetit Portual Durrës, ka qenë një aktivitet i organizuar vetëm me pjesëmarrjen e atyre që janë pasqyruar dhe në ftesë dhe në axhendë. Për më tepër dhe zonja Emiriana Sako, ka qenë e thirrur në cilësinë e kryetares së bashkisë dhe jo në cilësinë e kandidates për kryetare bashkie. Në përfundim edhe ne parashtrojmë dhe kërkojmë që nuk jemi përballë shkeljes së vendimit nr. 2 të 2022 të Komisionit

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Këto kemi kryesisht, nuk kemi gjë tjetër!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, e mbyllim shqyrtimin administrativ në lidhje me këtë denoncim dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë një ditë tjetër, për të cilën do të njoftohen palët zyrtarisht, faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

28.04.2022
Ora 12:47

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare” për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zonjës Eriselda Sefa, zonjës Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe zotit Pjerin Vogli, Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnje si dhe Bashkisë Lushnje”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Ylli Merkaj, Znj. Madalena Koja**
- **Parti Politike:** **PD, Z. Marash Logu**
- **OJQ:** **KRIK**
- **Të tjerë:**
 - Organizata “Qëndresa Qytetare”, zoti Rigels Xhemollari.
 - Spitali “Ihsan Çabeja”, znj. Andorna Sulo.

Z. I. Celibashi: Atëherë, kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje, propozuar nga Partia Socialiste, Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, drejtorit të Spitalit Lushnje si dhe Bashkisë Lushnje, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet kryetar bashkie të datës 6 mars. Atëherë, prezent janë përfaqësuesit e Organizatës “Qëndresa Qytetare”, nga Bashkia Lushnje, ka përfaqësues prezent? S’ka prezent!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*


Nga Ministria e Shëndetësisë? S'ka prezent! Nga spitali?

Znj. A. Sulo, përfaqësuese e Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnje: Po, prezent!

Z. I. Celibashi: Njoftimet i keni bërë? Në rregull! Atëherë hapim shqyrtimin administrativ në lidhje me këtë çështje, me këtë denoncim të Organizatës “Qëndresa Qytetare”. I japim fjalën përfaqësuesit të Qëndresës për të parashtruar pretendimet e tij në lidhje me sa ka prezantuar edhe në aktin e denoncimit. Pastaj palës prezente.

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Faleminderit! Në datën 16 shkurt në spitalin e Lushnjes, në prezencën e kandidatës për kryetare bashkie, zonjës Eriselda Sefa, ministres së shëndetësisë zonjës Ogerta Manastirliu dhe drejtuesit politik të Partisë Socialiste të Qarkut, Taulant Balla është zhvilluar një vizitë me rastin e investimeve të zhvilluara në këtë institucion. Ky aktivitet përkon me periudhën zgjedhore. Në referim të vendimit nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit, duke shkelur qartazi nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, pasi drejtues të organeve publike marrin pjesë në veprimtari të ndaluara. Promovojnë investime me interes publik dhe bëjnë takime elektorale për rikonstrukcion të godinës në prani të kandidatës Sefa. Në shkresën e përcjellë nga zonja Sefa, thuhet se “në vijim të fushatës dhe premtimeve zgjedhore, nuk mund të shmangnim as qytetarët që marrin kurim në spitale”. Duke konfirmuar karakterin elektorale të kësaj vizite. Shprehet se “sikurse rezulton dhe nga deklaratimet e zotit Balla, prezenca jonë në spital, ka qenë tërësisht në funksion të premtimeve për zgjedhjet vendore, Lushnje”. Pra, në këtë formë zonja Sefa, kandidatë për kryetare bashkie, pranon në mënyrë të pakontestueshme se kjo vizitë në spitalin e Lushnjes, ku kanë qenë prezent zoti Balla dhe ministria Manastirliu, pra në cilësinë e ministres,


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

kanë qenë tërësisht në funksion të fushatës zgjedhore, brenda një aseti publik, apo organi të administratës publike siç është spitali i Lushnjes ku është bërë fushatë. Kjo është e shoqëruar dhe me pamje filmike të cilat ne ua kemi vënë në dispozicion. Në referim të nenit 6, pika 3 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, “punonjësit të administratës publike i ndalohet të përdorë mjetet publike, funksionin, ose veprimtaritë shtetërore, ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie, koalicioni, apo kandidati në zgjedhje”. Në këtë rast zonja Manastirliu, në cilësinë e ministres së shëndetësisë, si një nga organet e larta të administratës publike, ka marrë pjesë në një aktivitet me veprimtari me karakter publik, në një kohë që përkon me periudhën zgjedhore. Rrjedhimisht prezenca e zonjës Manastirliu në cilësinë e saj, implikon favorizimin e kandidates në zgjedhje. Duke shtuar këtu që në këtë aktivitet mund të jenë përdorur edhe asete të tjera. Është përdorur makina që kanë udhëtuar për në Lushnje e të tjera. Lidhur me këto pretendime dhe me pretendimin për sa i përket parashtrimeve të palës tjetër se vizita ka qenë për shkak se kanë dashur të takojnë mjekët specializantë. Së pari, në shkresën nr. 372 prot. të datës 10.03 të drejtorit të spitalit, zotit Pjerin Vogli konfirmon se “në datën 16.02., ministria e shëndetësisë Ogerta Manastirliu, kishte në axhendë inagurimin e Qendrës Shëndetësore Gradisht, Lushnje”. Së dyti, në referim të fakteve publike, lajmi i vizitës së ministres Manastirliu është publikuar në disa media on-line në You Tube, në Agjensinë Telegrafike Shqiptare, e cila është një media e mirëfilltë kombëtare që flitet për investimet në spitalin e Lushnjes. Po ashtu, në qoftë se i referohemi pamjeve filmike të publikuara nga vetë pala në këtë proces, në të gjithë videon rreth dhjetë minuta, në asnjë moment nuk diskutohet, apo të përmenden mjekët specializantë. I gjithë diskutimi shtrihet në investimet e reja në spital ku janë laboratorët, ambjentet e sterilizimit, apo ambjentet e urgjencës. Nga pamjet gjithashtu vihet re se nga kjo vizitë nuk ka shpëtuar pa shkuar te pacientët

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

për të vërtetuar dhe pretendimin e kandidates, “që ne nuk mund t’i përjashtojmë dhe ata që kurohen në spital, nga fushata zgjedhore”. Së fundmi, kemi të bëjmë me një aktivitet që nuk rezulton të jetë raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shkelur kështu nenin 92 dhe nenin 4 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator. Si përfundim mund të them që kemi të bëjmë me një aktivitet në funksion të fushatës zgjedhore brenda një aseti publik. Kemi të bëjmë me një ministre e cila është vënë në dispozicion të një kandidateje për kryetare bashkie. Kemi të bëjmë me përdorim të burimeve shtetërore dhe premtime për investime të ardhshme. Kemi të bëjmë me një aktivitet që nuk është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi nqs do të ishte raportuar jam shumë i sigurtë që do të shpallej nga ana juaj, ndoshta një aktivitet i ndaluar. Për sa më sipër, kërkojmë që të konstatohet shkela nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe merren sanksionet administrative ndaj ministres së shëndetësisë, zonjës Ogerta Manastirliu, ndaj drejtorit të spitalit zotit Pjerin Vogli dhe ndaj kandidates zonjës Eriselda Sefa, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! I japim fjalën përfaqësuesit të spitalit Lushnje për të parashtruar pretendimet në lidhje me sa u prezantua nga përfaqësuesi i denoncuesit.

Znj. A. Sulo, përfaqësuese e Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnje: Në datën 15.02.2022, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u informua Drejtoria e Spitalit Lushnje se do të bëhej një mbledhje, konsultim me mjekët specialistë të cilët përfundonin kontratën në mars të 2022. Duke qenë se në axhendën e ministres në datën 16.02.2022 ishte inagurimi i Qendrës Shëndetësore Gradisht, me këtë rast u informua spitali Lushnje se takimi me mjekët specialistë do të bëhej në ambjentet e spitalit të Lushnjes. Për sa i përket

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

kandidates së Partisë Socialiste, Eriselda Sefa, ajo ka ardhur për të përmbushur një nga pikat e rëndësishme të kontratës që është bonusi i qerasë për mjekët të cilët ishin jashtë qytetit të Lushnjes. Këto janë pretendimet!

Z. I. Celibashi: Ne si institucion ju kemi drejtuar shkresë dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Lushnje dhe kemi marrë shpjegime në lidhje me çfarë përmban denoncimi. Ju të organizatës jeni njohur me ato?

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Po, jemi njohur me të gjitha dhe kemi bërë prapësimet tona.

Z. I. Celibashi: Keni ndonjë kërkesë për të marrë ndonjë shkresë, ndonjë dokumentacion tjetër?


Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Mendoj se është mjaft e qartë! Për ne është mjaft e qartë dhe jemi plotësisht të informuar.

Z. I. Celibashi: Nga ana e përfaqësuesit të spitalit, ka ndonjë kërkesë për të marrë ndonjë dokumentacion shtesë për ndonjë provë në lidhje me këtë shqyrtim administrativ?

Znj. A. Sulo, përfaqësuese e Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnje: Jo nuk kemi!

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, e mbyllim hetimin administrativ në lidhje me këtë çështje. Fjala për ju për diskutimin përfundimtar, për përfaqësuesin e Qëndresës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Atëherë, me sa dëgjova dhe nga përfaqësuesia e spitalit dhe në qoftë se ne do t’i referohemi videos që ne ju kemi vënë në dispozicion, por që dhe vetë përfaqësuesia e forcës politike, kandidatia ka ndarë në rrjetet sociale dhe ne mediat qendrore kombëtare, nuk flitet në asnjë moment as për mjekët specializantë, as për bonusin e qerasë për mjekët specializantë, por flitet për investimet, për inspektimet, për premtime të ndryshme. Në atë se ç’ka ne kemi evidentuar, kemi përdorim dhe shkelje të disa normave dhe neneve qoftë të Kodit Zgjedhor, qoftë të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator. I qëndrojmë pretendimit tonë për të konstatuar shkelje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, por qoftë dhe për të marrë masa administrative ndaj ministres së shëndetësisë, ndaj kandidatës për kryetare bashkie zonjës Eriselda Sefa dhe ndaj drejtorit të spitalit pasi është vënë në funksion të kësaj fushate, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesia e spitalit përfundimisht në lidhje me çfarë u kërkua nga përfaqësuesi i Organizatës “Qëndresa Qytetare”?

Znj. A. Sulo, përfaqësuese e Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnje: E rrëzoj poshtë duke qenë se ky takim është bërë vetëm për mjekët specializantë dhe jo për pjesën e fushatës.

Z. I. Celibashi: Vlerësoni se nuk ka vend për vendosje të sanksioneve administrative?

Znj. A. Sulo, përfaqësuese e Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnje: Po!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfundojmë shqyrtimin administrativ të kësaj çështje dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë në një seancë tjetër publike, për të cilën do të njoftohen palët zyrtarisht.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

28.04.2022
Ora 12:57

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare” për shkelje të parashikuar në nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit Bashkiak Shkodër”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja**
- **Parti Politike:** **PD, z. Marash Logu**
- **OJQ:** **KRIK**
- **Të tjerë:**
 - **Organizata “Qëndresa Qytetare”, zoti Rigels Xhemollari.**
 - **Sekretari i Këshillit Bashkiak Shkodër, zoti Denis Lezha.**

Z. I. Celibashi: Atëherë, kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj kryetarit dhe sekretarit të Këshillit Bashkiak Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore të datës 6 Mars 2022. Atëherë, përfaqësuesi i Organizatës “Qëndresa Qytetare” është prezent. Nga Këshilli Bashkiak Shkodër përfaqësues të kryetarit, apo sekretarit kemi prezent?

Z. D. Lezha, sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Po, prezent!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Z. I. Celibashi: Ju jeni vetë sekretari i këshillit?

Z. D. Lezha, sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëherë e deklarojmë të hapur hetimin administrativ në lidhje me këtë denoncim. I japim fjalën përfaqësuesit të Organizatës “Qëndresa Qytetare” për të prezantuar edhe njëherë se sa denoncimi i tyre përmban në lidhje me këtë çështje.

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Në fakt ky lloj kallëzimi është i një natyre tjetër. I një natyre që lidhet me nxjerrjen e akteve publike gjatë periudhës zgjedhore. Ne kemi konstatuar se në datën 4.02.2022 referuar edhe vendimit nr. 2, dt. 22.01.2022 të Komisionit Rregullator për zgjedhjet e pjeshme vendore të 6 marsit, Këshilli Bashkiak Shkodër si organ publik përfaqësues, ka marrë vendime të cilat bien ndesh me Kodin Zgjedhor për periudhën elektorale si më poshtë:

- Miratimin e listës së përfituesve dhe vlerën e subvencionimit të qerasë për ata individë apo familje që nuk përballojnë qeranë në tregun e lirë për gjithë vitin 2022.
- Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur, ose të emëruar. Të nëpunësve dhe të punonjësve të administratës së Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë. Këtu ne konstatojmë që ka dhe një farë rritje të pagave për këtë periudhë.
- Miratimin e vlerësimit paraprak të masës së shpërblimit për shpronësim për interes të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga investimet publike të realizuara nga Bashkia Shkodër.
- Dhënia e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri dhe;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Për përdorim të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar mbi ndihmën ekonomike deri në 6%.

Kodi Zgjedhor, neni 91 dhe pika 4 e vendimit të Komisionit Rregullator, parashikon ndalimin e propozimit, miratimit, ose nxjerrjes së akteve ligjore, apo nënligjore siç janë në këtë rast vendimet e këshillit bashkiak, të cilat parashikojnë rritjen e pagave, mbështetjen sociale, heqjen e taksave, apo dhënien e shpërblimeve. Elementë që i gjejmë tek vendimet që janë miratuar më 4.02.2022. Po në datën 28.02 është njoftuar mbledhja e këshillit bashkiak e cila është realizuar në datën 3.03.2022, në kundërshtim edhe me vetë rregulloren e këshillit bashkiak. Konkretisht neni 37 i cili parashikon realizimin e mbledhjes jo më parë se 5 ditë nga njoftimi i saj. Mbledhja duhej të ishte realizuar pikërisht 5 ditë pas njoftimit dhe duhej bërë një ditë pas zgjedhjeve në qoftë se do të përfshinin edhe të shtunën dhe të djelën. Kështu që mbledhja është bërë në datën 3 dhe janë miratuar kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, por trajtohen nga një fond shtesë nga fondi i kushtëzuar 6% të ndihmës ekonomike. Nga sa më sipër, ne konstatojmë se është shkelur neni 91 dhe pika 4 e vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator. Për këtë arsye ne kërkojmë: konstatimin e shkeljes nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Marrjen e masave për anëtarët e këshillit bashkiak, kryetarin e këshillit bashkiak dhe personat e përfshirë, pjesë e kësaj vendimmarrje, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit ju! Sekretar i këshillit i cili është prezent këtu, në lidhje me këto pretendime. Ju jeni njohur më parë me këtë denoncim, apo jo?!

Z. D. Lezha, sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Po, po jemi njohur. Faleminderit zoti Komisioner. Së pari, më lejoni të falenderoj Qëndresën Qytetare,

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

sepse pjesa dërrmuese e denoncimeve vinin nga kjo organizatë. Inkurajoj që të kontribuoni edhe në mënyrën më pro aktive të organeve të qeverisjes vendore për të kuptuar ndoshta më realisht, nevojat e qytetarëve. Rolin e qytetarit në vendimmarrje dhe jo vetëm nëpërmjet denoncimeve që është pak agresive si marrëdhënie. Megjithatë, së pari nga pikëpamja formale. Jemi denoncuar unë në cilësinë e sekretarit të këshillit dhe kryetaria e këshillit, për vendimmarrje të një organi kolegjial. Ligji “Për Qeverisjen Vendore” është shumë i qartë te roli, detyrat dhe kompetencat qoftë të kryetarit, qoftë të sekretarit të këshillit. Kryetari i këshillit është në anglisht “head speaker”, drejton mbledhjen dhe nuk ka asnjë atribut mbi vendimmarrjen e këshillit. Vota e tij është e barabartë me të tjerët. Sekretari i këshillit është një funksion tërësisht administrativ dhe dokumentar. Kjo do të thotë që të gjitha shkresat dhe vendimet që vijnë pranë këshillit bashkiak, administrohen dhe i vihen në dispozicion këshillit bashkiak. Për më tepër aktet e propozuara nga kryetari i bashkisë si organ ekzekutiv të miratuar nga këshilli bashkiak si organ përfaqësues të jetë ky sekretari i këshillit që të vendosë t’i kalojë apo jo për shqyrtim. Unë uroj ta kem këtë kompetencë, po ndryshoni ligjin e pastaj po mbaj përgjegjësitë. Nuk besoj se jemi në kompetentët për këtë lloj vendimmarrje. Sa i përket afateve të shqyrtimit të projektvendimeve. Unë besoj se nuk është objekt i shqyrtimit të KQZ-së. Ato janë afate të brendshme organizative. Nuk jemi para vendimeve që kërkojnë në bazë të nenit 18 të Ligjit 139 “Për Qeverisjen Vendore”, seanca konsultimi me publikun që do të ishim të detyruar të respektonim afate të tjera ligjore. Jemi para disa vendimeve rutinë të këshillit bashkiak. Sigurisht nuk jemi dakord me asnjë nga konstatimet që ka bërë organizata. Së pari, neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon “katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve, ndalohet propozimi, miratimi, ose nxjerrja e akteve ligjore, ose nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategoritë e caktuara të


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

popullsisë. Të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike, apo sociale, uljen e taksave, vendosjen e amnistive, privatizime, apo dhënie pasurish, shpërblimeve, etj... Mendoj se nuk jemi para këtij neni. Ky nen flet qartë që ka të bëjë me zgjedhjet e organeve të qeverisjes së përgjithshme, pra zgjedhjet parlamentare. Vetë fjala “deri në formimin e qeverisë së re..”. Ne nuk ishim para zgjedhjeve që do të konkludonim me një qeveri të re. Edhe nëse do të ishim në qeverisje lokale, përsëri nuk jemi para zgjedhjeve që do të konkludonim në formim, ose konstituim të organit përfaqësues që është këshilli bashkiak. Ishim në zgjedhje të pjesshme vetëm për kryetar bashkie. Megjithatë edhe nëse do të ishim para këtij neni përsëri nuk konstatohet shkelje e këtij neni. Vendimmarrja që është marrë.., ndihma ekonomike deri në 6%, të nderuar duhet të dini që ndihma ekonomike fillimisht aplikohet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social, aplikohet çdo muaj. Pasi konkludon shërbimi social dhe refuzon një pjesë, kjo pjesë kalon në bashki deri në 6% të fondit. Fondi është i përcaktuar nga qeveria shqiptare. Fondi jepet me shkresë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, sepse kështu i bie që dhe kjo drejtori nuk duhet të japë ndihmë ekonomike katër muaj para zgjedhjeve. Nga ana tjetër, neni është i qartë, parashikon rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike sociale. Pra, ti nuk mund të pengosh një veprimtari normale shtetërore. Unë as nuk kam rritur pagë, as nuk kam rritur pension, as rritje të mbështetjes ekonomike dhe sociale. Pse është për qeverinë kjo punë? Sepse unë nuk di ndonjë ligj në shtetin shqiptar që ka atribut qeverisja vendore që të rrisë paga, pensione, mbështetje ekonomike. Ne punojmë mbi bazën e akteve ligjore dhe nënligjore të shtetit shqiptar, zotëri! Ne nuk rrisim paga! Paga rrit qeveria! Unë të bëj një pyetje, po të duash merre retorike, po të duash mos u përgjigj! Në se një javë para periudhës zgjedhore, qeveria vendos me rrit pagën minimale, këtë pagë minimale unë jam i detyruar në këshillin bashkiak ta vendos si nivel page. Këtë nivel page unë e vendos

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

në periudhë zgjedhore. Unë kam rritur pagën? Unë kam bërë shkelje? Çfarë do të bëj? Të le punonjës in në mënyrë të paligjshme të marrë një pagë që nuk është më në fuqi?! Pra, pagat nuk i rrisim ne. Ne përcaktojmë nivelin e pagave mbi bazën e kufirit minimal dhe maksimal që ka përcaktuar vendimi i qeverisë me ndryshimet e tij. Madje ne aktualisht kemi në shqyrtim nivel pagash tjetër, sepse ka ndryshuar paga minimale në vend në datën 12.03, ka ndryshuar sërish dhe niveli i pagave për punonjës të caktuar të administratës dhe nëpunësve civilë. Pra, pjesa e 6% është një rutinë çdo mujore e këshillit bashkiak dhe Drejtorisë së Shërbimit Social. Subvencionimi i qirasë është praktikë vjetore. Fillon me aplikuesit të cilët kanë aplikuar që në muajin nëntor të vitit 2021. Ka një komision të brendshëm në këtë bashki i cili vlerëson të gjitha aplikimet, përcakton listën dhe e kalon në këshillin bashkiak. Nuk kemi rritje këtu, as të ndihmës ekonomike dhe sociale, thjesht kemi një aplikim të vetë dispozitave ligjore që janë për këtë situatë. Po ashtu dhe pagat. Skedulimi i pagave.., ne skedulojmë paga, ne nuk rrisim paga. Skedulojmë nivelin e pagave në bazë të ndryshimeve adekuate që janë nga vendimi i qeverisë. Nuk rrisim paga! I skedulojmë, i riskedulojmë dhe duhet të dini që fondi i pagave miratohet me buxhetin e Këshillit të Bashkisë Shkodër. Pra, në qoftë se unë do të kem rritje page, duhet të lëviz fondin e pagave. Unë fond pagash nuk mundem të lëviz, e kam të miratuar me datën 5.01.2022, me buxhetin e bashkisë për vitin 2022. Në lidhje me dëmet nga zjarri! Tani unë nuk e kuptoj, të arrini të denonconi pse japim dëmshpërblim në rast fatkeqësie natyrore, sinqerisht të paktën këtë ta kursenit, dëmshpërblimin nga zjarri! Ka fatkeqë që u është djegur shtëpia o zotëri! Ka afate procedurale për konstatimin e zjarrit. Unë nuk mund të pres katër muaj për të konstatuar zjarrin, se si i ka rënë atij. Ka dhe diçka! Është qëllimi elektoral i këtij neni! Bashkia Shkodër ka një specifikë! Kryetari i bashkisë është i PD-së, ne të këshillit jemi të PS-së. Propozuesi i këtyre akteve është i PD-së, miratuesi është i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

PS-së. Tani, cilin elektorat kemi dashur të favorizojmë, se nuk po marrim vesh se ku ka shkuar ajo votë! Edhe kjo është një dilemë shumë e bukur! Në fakt, ju duhet të kishit denoncuar propozuesin e aktit, që është kryetari i bashkisë, sepse propozuesi i aktit është ai që ka komplet administratën, bën relacionet përkatëse dhe i sjell për shqyrtim në këshillin bashkiak. Këshilli bashkiak është organ kolegjal, nuk ka administratë, që ta dini! Ka vetëm një sekretar këshilli i cili mbledh dhe përcjell letra. Pra, duhet të angazhoheni pak dhe me ligjet për qeverisjen vendore! Që të kemi një këshill bashkiak të pavarur, duhet që ky këshill të ketë një administratë. Ne e kemi të pamundur që të shqyrtojmë pikë për pikë çdo propozim që sjell administrata e bashkisë bashkë me kryetarin, a kushdo qoftë. Megjithatë nuk është ky problemi ynë sot. Gjithësesi dëmshpërblimi nga zjarri është një procedurë brenda kornizave ligjore. Nuk ka asnjë lloj përparësie në lidhje me ata fatkeqë që u ka ndodhur. Pjesa e dëmshpërblimit për interes të shpërblimit për dëm publik, ka filluar që në 2021. Është një proces që nuk mbaron me vendimin e këshillit bashkiak, i nderuar! Vendimi i këshillit i nisët qeverisë shqiptare për ta miratuar. Ata nuk kanë ardhur te ne, kemi shkuar ne tek ata. I kemi prishur shtëpitë për të ndërtuar rrugën. Do të dëmshpërblehen, apo t'u themi "nuk ju dëmshpërblejmë dot se jemi katër muaj para zgjedhjeve"! Mua nuk më duken të arësyeshme. E fundit që dua të them, çdo vendimmarrje e këshillit bashkiak kalon për shprehje ligjshmërie në prefektin e qarkut. Do t'u lutesha shumë, mos më besoni mua, për çdo vendim merrni nga një kopje dhe çojeni te prefekti i qarkut. Nëse është shprehur te një vendim i vetëm që "zotëri je para kushteve të ndalimit", se ai është përfaqësues i qeverisë ai zotëri, në se në një vendimmarrje të më ketë thënë mua... sepse si i bie tani, nëse ai më ka thënë mua që "je në rregull" dhe Komisioneri më thotë "s'je në rregull"! Ku jam unë? Ta kuptoj dhe unë se ku jam! Merreni atë informacion, mos e mbyll procesin administrativ! Nëse do, merreni atë informacion te prefekti dhe i thuaj "o zotëri, a je

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

shprehur diku ti që je në kushtet e ndalimit për shkak të periudhës zgjedhore”? Prandaj, unë po e mbyll edhe diskutimin përfundimtar për procedurë, jemi kundër për sa kanë konstatuar!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesi i Qëndresës, ndonjë kërkesë për marrje të ndonjë dokumentacioni, apo ndonjë pyetje në lidhje me sa u shpjeguan nga sekretari i këshillit të bashkisë?

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Jo, në fakt nuk është se duam dokumenta shtesë. Në se më lejon të bëj një koment meqenëse shpesh herë u përmend roli dhe funksioni që ne luajmë në këtë proces. Dihet që ne udhëhiqemi nga parimi i zbatimit të ligjit dhe jo nga ndjesitë, apo se çfarë organet, qoftë të qeverisjes vendore, apo qoftë të qeverisjes qendrore ndërmarrin. Për sa i përket vendimit, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me katër muaj para zgjedhjeve, por kemi të bëjmë me një vendim tjetër të Komisionit Rregullator, të cilin unë e kam përmendur edhe në fillim të seancës, që është vendimi nr. 2, dt. 22.01.2022, për sa i përket periudhës zgjedhore ku organet as nuk duhet të përdorin asetet, as nuk duhet të përdorin burimet njerëzore dhe as nuk mund të nxjerrin akte që i shërbejnë fushatës elektorale. Në këtë kuptim, sekretari i këshillit bashkiak, ndoshta nuk është personi i duhur për të qenë subjekt i këtij kallëzimi. Unë mendoj me sa kemi konstatuar dhe sjellë në këtë kallëzim, anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryetari i këshillit bashkiak të cilët janë pjesë e kësaj vendimmarrje duhet të jenë personat objekt i këtij gjykimi. Dua të theksoj se ju mund të thoni që “është çështja e ndihmës financiare nga zjarri dhe duhet të dëmshpërblehen”, por unë po ju përmend edhe nenin 328 të “Kodit Penal”, ku përdorimi i postit publik për fushatë zgjedhore, apo veprimtaritë shtetërore në funksion të fushatës zgjedhore, janë vepër penale dhe dënohen me burgim,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

ndonjëherë deri në tre vite. Kjo është një çështje shumë serioze. Ne e kemi marrë shumë seriozisht, pa ngjyra politike dhe ju e shihni që ne nuk kemi konsideruar në se jeni të Partisë Demokratike, apo Socialiste. Të gjitha kallëzimet tona kanë qenë thjesht dhe për zbatim të ligjit elektoral, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po!


Z. D. Lezha, sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Tani ju vetë e patë që asnjë palë nga bashkitë e tjera nuk ishin prezent dhe unë jam prezent. Seriozisht e kam marrë dhe unë këtë çështje, madje shumë seriozisht. Me gjithë dëshirën për të pas një pikë takimi në konstatimin tuaj, aq më tepër vepër penale pastaj, ti qofsh, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Kemi kërkesa në lidhje me marrje prove? Asnjë prej palëve s'ka! Atëherë, e përfundojmë hetimin administrativ për këtë çështje. Fjala e fundit, për përfaqësuesin e Organizatës “Qëndresa Qytetare”!

Z. R. Xhemollari, Organizata “Qëndresa Qytetare”: Bazuar në të gjitha pretendimet tona për sa i përket këtij kallëzimi, ne kërkojmë konstatimin e shkeljes nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për kryetarin dhe anëtarët e këshillit bashkiak të cilët kanë marrë vendime në periudhë zgjedhore dhe marrjen e masave administrative për këto subjekte, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Sekretari i këshillit bashkiak, fjala e fundit për ju?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.04.2022*

Z. D. Lezha, sekretar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Të mos merren masa administrative, këtë kërkoj nga ju!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! E mbyllim shqyrtimin administrativ të kësaj çështje dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë në një seancë tjetër publike, për të cilën do të njoftohen palët zyrtarisht, faleminderit palëve dhe pjesëmarrësve për kontributet e tyre, ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

